



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

V E N D I M

Nr 52 Datë. 23 /12/2025

MBI MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL  
PËR VITIN 2026

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të neneve 18 dhe 26 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në Kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, dhe të VKM-së nr. 108, datë 26.02.2014, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”; me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë,


V E N D O S I:

1. Të miratojë Planin Vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil për vitin 2026 në Këshillin e Qarkut Korçë. Bashkëngjitur Plani Vjetor i Pranimit në Shërbimin Civil.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori Juridik, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas konfirmimit nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

KRYETARI

Petrika Tëllkuçi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Nr. 8/1 Prot.

Korçë, më 12.12.2025

**PLANI VJETOR I PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL NË  
KËSHILLIN E QARKUT KORÇË PËR VITIN 2026**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe të nenit 18 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, dhe të VKM-së nr. 108, datë 26.02.2014, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, Njësia e Burimeve Njerëzore ka hartuar Planin Vjetor të Pranimit/Rekrutimit në Shërbimin Civil për vitin 2026.

Numri i vendeve vakante për të cilat do të shpallet konkurrimi për vitin 2026 është 1 (një), si më poshtë:

1. Përgjegjës i Sektorit për Projektet e Zhvillimit

- Kategori: e ulët drejtuese
- Klasa e pagës: III-2
- Grupi i diplomës: (1), sipas përcaktimit në lidhjen nr. 7 të VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024

Bazuar në VKM-në nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, plotësimi i këtij vendi vakant do të realizohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, të cilat aplikohen njëkohësisht.

Pas miratimit të Planit Vjetor të Pranimit në Këshillin e Qarkut Korçë, do të bëhet shpallja e vendit vakant dhe publikimi i procedurave përkatëse, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**NJËSIA PËRGJEGJËSE PËR MENAXHIMIN  
E BURIMEVE NJERËZORE**

**Redin Latollari**